



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

PROGRAMI BUXHETIT AFATMESEM 2019-2021

BASHKIA SKRAPAR

TBELA E LENDES

1-Veshtrim I Pergjithshem

- 1.1-Situata e njesise veteqeverisjes vendore
- 1.2-Çeshtjet kryesore per projektet dhe politikat e nj.q.v-se
- 1.3-Informacion financiar themelor

2-Orjentimi afatgjate i njesise qeverisjes vendore

- 2.1-Strategjia e zhvillimit afatgjate/strategjia teritoriale
- 2.2-Sfidat kryesore te zhvillimit

3-Projektet kryesore te PBA-se 2019-2021

- 3.1Paraqitja e projekteve kryesore –arsyet dhe perfituesit
- 3.2-Plani shpenzimeve kapitale/projektplani 2019-2021

4-Informacion financiar

- 4.1-Supozimet e planifikimit
- 4.2-Burimet e te ardhurave
- 4.3-Shpenzimet
- 4.4-Buxheti total
- 4.4-Informacion financiar shtese
 - 4.4.1-Huamarrjet
 - 4.4.2-Te prapambeturat
 - 4.4.3-Treguesit financiar
 - 4.4.4-Rreziqet financjare

5-Informacion per programet buxhetore

- 011:Organet ekzekutive dhe legjislative,çeshtjet financjare dhe fiskale,çeshtjet e brendeshme
- 013:Sherbime te pergjithshme
- 031:Sherbime policore
- 032:Sherbime e mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtja civile
- 042:Bujqesia,pyjet,peshkimi dhe gjuetia
- 045:Transporti
- 051:Menaxhimi mbetjeve
- 062:Zhvillimi komunitetit
- 064:Ndriçimi rrugeve
- 081:Sherbimet rekreative dhe sporti

082:Sherbimet kulturore
091:Artsimi baze dhe parashkollor
092:Artsimi mesem
101:Semundjet dhe paaftesia
104:Familje dhe femijet
107:Ndihma ekonomike

6-Monitorimi i zbatimit te strategjise

6.1 Hyrje rezultati pergjithshem dhe perfundimi
6.2Lista e masave strategjike per çdo fushe prioritare

7-Shtojcë

7.1-Rregjistri asetëve
7.2-Kontratat e Qirave
7.3-Paketa Fiskale
7.4-Vleresimi shpenzimeve te planifikuara si pjese e paketes fiskale
7.5-Pershkrimi metodologjise se perlllogaritjes se te ardhurave
7.6-Plani fluksit monetar

1.Vështrim i përgjithshëm:

Bashkia Skrapar shtrihet brenda territorit te qarkut Berat.Rajoni gjendet ne pjesen qendrore dhe ate jugore te trungut te brendshem te vendit dhe ka si kryeqender qytetin e Çorovodes.Ne nivel qarku bashkia shtrihet ne pjesen juglindore dhe kufizohet ne very me bashkine e Gramshit te qarkut te Elbasanit ndersa ne lindje me bashkine Maliq dhe Korçe te qarkut te Korçes.Ne jug kufizohet me bashkine Kelcyre dhe Permet te qarkut te Gjirokastrës,dhe ne perendim me bashkine Poliçan te te njejtë qark.

-Siperfaqja e pergjithshme e bashkise Skrapar eshte 83.327 ha.

-Kryeqendra e bashkise Skrapar eshte qyteti Çorovodes.Si rezultat i reformes bashkia Skrapar u krijua nga bashkimi i 9 njesive te qeverisjes vendore tete komuna dhe nje bashki.Tete ish komunat sot njesi administrative perbehen nga 103 fshatra.Teritori bashkise shtrihet ne zonen gjysem malore dhe malore,mjedisi natyror eshte i paster dhe me shumlojshmeri peisazhesh, dhe burime te pasura natyrore dhe ujore.Elementet natyror te njohur jane kanionet e Osumit dhe Parku Kombetar i Tomorrit si nje destinacion i rendesishem turistik qe ndikojne ne rritjen e ekonomise lokale.I pasur dhe i vlefshem eshte dhe mjedisi kulturor me monumente te shumta kulturore me vlera kombetare dhe rajonale.Persa i perket infrastruktures se transportit ,Bashkia mban lidhje rrugore me qytetin kryesor rajonal Beratin i cili eshte qendra urbane me e afert dhe me e madhe.Gjendja e rrugeve ne zonat dhe vendbanimet me te largeta eshte veçanrisht problematike duke pasur parashysh siperfaqen e madhe te bashkise dhe distancen e madhe ne kilometra te rrjetit qe lidhin qytetin me qendrat e njesive administrative,si dhe njesit administrative me fshatrat dhe fshatrat midis tyre.Numri popullsise i rregjistruar sipas censusit te fundit ne kete bashki ka dale 12.403 banor.Ndersa numri popullsise i rregjistruar ne gjendjen civile eshte 17.486 banor.Numri banoreve eshte pakesuar ne mase te konsiderueshme nga braktisja e zonave rurale per shkak te mungeses infrastruktures rrugore,sherbimit shendetesor,pamundesise se kryerjes arsimit sidomos ati te mesem,por dhe te mungeses se punonjesve te kualifikuar ne kete sektor.Pavarsisht mungeses se infrastruktures rrugore pozita gjografike,pasuria natyrore dhe ujore, historia dhe traditat,perbejne nje potencial per zhvillimin ekonomik te kesaj zone.

1.2 Çeshtjet kryesore per projektet dhe politikat e bashkise

1-Çeshtje kryesore dhe me problematike eshte infrastruktura rrugore.Projektet dhe politikat afatmesme dhe afatgjata te bashkise konsistojne ne ndrhyrjen per permisimin e akseve rrugore qe lidhin qytetin qender bashkie me qendrat e njesive administrative,dhe me pase me permirsimin e rrjetit rrugor midis njesive administrative dhe midis fshatrave.Eshte vertet nje sfide pasi jane tete njesi administrative qe lidhen me qytetin qender e bashkise ,me nje largesi te konsiderueshme .

2-KUZ-Problem serioz sidomos rrjeti ujsjellesit,dhe ujrave te zeza ne qytetin e Çorovodes.Nje rrjet tejet I amortizuar,me problematike dhe defekte te shumta kerkon nderhyrje te menjehershme,eshte neder prioritetet kryesore te politikave te investimeve te bashkise pasi lidhet me drejperdrejt me shendetin e banoreve te qytetit shpesh ndoth qe nga carja e tubacioneve te amortizuara te rrjetit te ujsjellesit te bashkohen uji pijshem me ujrata ndotura nje rrezik potencial per shfaqje epidemie.Eshte akorduar fondi per projekin e KUZ-qyteti Çorovode dhe shum shpejt do te jete gati per zbatim.

3-Mirmbajtja dhe zgjatja e rrjetit ujites.Burimet ujore jane te konsiderueshme,sidomos rezervuaret te cilet jane te shumte ne teritorin e bashkise por qe kerkojne nderhyrje per rehabilitime dhe zgjatje te kanaleve ujites me synimin rritjen e siperfaqes se tokes nen uje.Kjo do te sillte nxiste fermeret te rritnin siperfaqen e kultivuar te tokes pasi dhe ujitjave do te ndikonte ne rritjen e rendimentit te prodhimin kjo me interes per fermret.

4-Mbrojtja e mjedisit eshte prioritet ne politiken e investimeve afatmesme prandaj dhe sinimi eshte permirsimi i sistemit te menaxhimit te mbetjeve,ndertimi landfillit,rikonstrukcion I vendepozitimeve te mbetjeve.

5-Qyteti Çorovodes ndodhet midis dy lumenjve te cilet ne periudhen e rreshjeve perbejne nje rrezik potencial per dalje nga shtrati dhe permbytje te qytetit.Prandaj eshte e domosdoshme ndertimi veprave kunder permbytjes dhe vepra te mbrojtjes lumore.

6-Pyllezimi I kurores qytetit dhe mbjellja e pemeve ne zona te caktuara te qytetit eshte prioritet I politikave te investimeve me synimin dhe per mbrojtjen nga erozioni pasi vete konfiguracioni qytetit eshte I till qe rreshjet e shumta munde te shkaktojn demtime ne rrug, rrjete banesa etj.

7-Gazsjellesi TAP kalon shum afer qytetit te Çorovodes prandaj eshte prioritet krijimi infrastructures per shfrytezimin e gazit natyror qofte per bizneset apo familjaret kjo do ti kontibuonte uljes kosos per ngrohje,gatim apo dhe per sherbime te tjera.

8-Sherbimi shendetesor sidomos ne zonat rurale por dhe ne qendrat e njesive administrative pothuajse nuk egziston kjo per shkak edhe te mungeses ambjenteve si abulanca dhe qendra shendetesore.Shihet si prioritet edhe ky sektor I rendesishem qe lidhet direkt me jeten e banoreve te zones.

9-Krijimi kushteve te pershtateshme ne shkollat ekzistuese si dhe ndertimi objekteve te reja shkollare ne qytet dhe ne ato fshatra ku numri nxenesve e justifikon kete sherbim.

1.3 Informacion financiar kryesor

-Te ardhurat e veta te bashkise sipas viteve paraqiten ne treguesit e meposhtem:

Per vitin 2016 realizimi te ardhurave ka qene ne vleren 95.394.000 leke. E krahasuar me te ardhurat e realizuara ne vitin e fundit para reformes administrative teritorjale(vitin 2014) eshte rritur me shum se dy here.Po ashtu dhe fakti I vitit 2017 eshte ne nivele te kenaqshme ne vleren 97.451.000 leke.Parashikimi per vitin 2018 eshte 100.000.000 leke, ndersa per vitin 2019=107.577.000 leke vitin 2020 =110.272.000 leke per vitin 2021= 114.157.000 leke.Si vihet re kemi nje parashikim ne rritje te te ardhurave per periudhen 2019-2021 por kjo duke mare ne konsiderat dhe faktin qe guroret dhe nxjerrja e mermerit te lejohen te vazhdojne aktivitetin pasi pjesa me e madhe e te ardhurave eshte parashikuar te sigurohet nga keto dy aktivitete.

Transferta e pakushtezuar sipas viteve paraqitet si me poshte:

Per vitin 2016 transferta e pakushtezuar eshte akorduar ne vleren 109.321.000 leke, ne vitin 2017 transferta specifike se bashku me transferten nga fondi reserve I qeverise eshte akorduar ne vleren 151.145.000 leke , ne vitin 2018 transferta specifike eshte akorduar ne vleren 116.888.000 leke ne vitin 2019 parashikohet te akordohet ne vleren 119.551.000 leke ne vitin 2020 parashikohet te akordohet ne vleren 128.399.000 leke dhe ne vitin 2021 parashikohet te akordohet ne vleren 141.115.000 leke.Ne krahasim me transferten e pakushtezuar te akorduar ne vitet para reformes administrative teritorjale transferta e akorduar nga viti 2016 e me pase ka qene me e ulet.Per realizimin e treguesve buxhetor nje ndikim pozitiv ka pasur rritja e nivelit te realizimit te te ardhurave te vet ate bashkise.Kjo si rezultat I nje pune te mire te bere nga administrate e bashkise ne teresi dhe nga sektori te ardhurave ne veçanti.

Transferta Specifike sipas viteve paraqitete si me poshte:

Per vitin 2016 transferta specifike eshte akorduar ne vleren 76.394.000 leke ne vitin 2017 eshte akorduar ne vleren 92.321.000 leke dhe ne vitin 2018 eshte akorduar ne vleren 99.711.000 leke. Pjesa me e madhe eshte me destinacion per paga dhe sigurime shoqerore dhe shum pake per shpenzimeve operative dhe aspak per investime.Programet buxhetore qe mbulon kjo transferte kan nevojte per me shum fonde sidomos per mirmbajtje objektesh ndertimore arsimit 9 vjeçar edhe pse bashkia eshte pergjegjese per mirmbajtjen e ketyre objekteve eshte shum e veshtire pasi numri I madh I shkollave ,tejet te amortizuara si dhe marja e ambjenteve me qira rrit shpenzimet ne nje mase te pa perballueshme nga buxheti bashkise.

Shpenzimet sipas viteve parashikohen te jene si me poshte:

Per vitin 2019 parashikohen shpenzime ne vleren 318.689.000 leke te ndara ne paga dhe sigurime 197.792.000 leke ,shpenzime operative ne vleren 78.024.000 leke dhe investime ne vleren 42.873.000 leke.

Per vitin 2020 parashikohen shpenzime ne total ne vleren 330.237.000 leke te ndara ne paga dhe sigurime 197.793.000 leke, shpenzime operative 81.074.000 leke, dhe investime 51.370.000 leke.

Per vitin 2021 parashikohen shpenzime ne total ne vleren 346.833.000 leke te ndara per paga dhe sigurime 197.793.000 leke shpenzime operative ne vleren 99.524.000 leke dhe per investime ne vleren 49.516.000 leke.

Si vihet re niveli pagave dhe sigurime eshte I pandryshuar ndersashpenzimet operative dhe investimet kane nje far rritje, synimi eshte te permirsohet gjendja financjare e bashkise duke shlyer te gjitha detyrimet e parapambetura Brenda periudhes 2019-2021.

2.Orjentimi afatgjat I bashkise Skrapar

2.1-Strategjia e zhvillimit afatgjat

Per tu realizuar vizioni per Bashkine Skrapar jane zhvilluar kater objektiva strategjike te cilat do te drejtojne zhvillimin ne te gjithe siperfaqen teritoriale te bashkise gjat viteve ne vazhdim.

Objektivi Strategjik :1

-Rigjenerimi ekonomik i zones.Zhvillimi balancuar I metejshe ekonomik I zones munde te arrihet perms zhvillimit te qendrueshem te sektorit bujqesor-blektoral dhe njekohesishte perms fuqizimit te sektorit te perpunimit te produkteve bujqesore dhe blektorale dhe promovimit te formave alternative te turizmit.Ky zhvillim ekonomik pritet te kontribuojte dhe ne rigjenerimin e popullsise perkatese si dhe frenimin e flukseve migratore e cila do te ndikoj ne rritjen e popullsise.

Objektivi Strategjik :2

-Menaxhimi qendrushem i mjedisit.Ky objektivi strategjik I referohet mbrojtjes dhe perdorimit te drejt te sistemeve te tokes dhe ato ujore,mbrojtjes se habitateve dhe ekosistemeve(Parku kombetar ne Tomor,promovimi dhe zhvillimit te peisazheve natyrore dhe gjeomonumenteve,kanionet e osunit dhe kanine te tjera) ne menyre qe te arrihet ruajtja e mjedisit natyror te paster, I cili munde te jete burim I rendesishem per pritjen e formave te ndryshme alternative te turizmit .

Objektivi Strategjik :3

Zhvillimi Infrastruktures Teknike.Eshte i nevojshem ndertimi dhe perfundimi I infrastruktures teknike per re permirsuar aksesin e njerezve dhe mallrave ne qendren e Bashkise ,por edhe ne qendra me te vogla administrative ne teritorin e Bashkise si dhe ne resurset turistike qendrat urbane rajonale,dhe infrastrukturave strehim,argrtim,prijtes,qe do te çojne ne rimekembjen e zones.Ne nivel bashkiak eshte problematike levizja dhe transporti I njerezve dhe mallrave nga zonat me te largeta ne ato qendrore.

Objektivi Strategjik :4

Zhvillimi komuniteteve te qendrueshme.Duke formuar komunitete te qendrueshme synohet permersimi I cilesis jetes banoreve dhe promovimi I identitetit te forte te bashkise ne lidhje me produktet bujqesore dhe blektorale cilesore dhe burimeve natyrore .

2.2-Sfidat kryesore te zhvillimit

-Nisur nga pozicioni gjeografik teritori bashkise Skrapar eshte I larmishem ka lumenj,kodra,male,lugina ,pyje kullota,qe faforizojne zhvillimin e pemtarise dhe blektorise.Sfidat jane (a)-shpopullimi I ketyre zonave me potencial ne zhvillimin e bujqesise dhe blektorise.(b)-mungesa e infrastuktures rrugore e cila pamundeson levizjetn e njerezve dhe mallrave ne zonat urbane. (c)-Mungesa e sherbimit shendetesor per arsye te mungeses personelit qe ofrojne kete sherbim dhe qendrave shendetesore dhe abulancave .(d)-Mungesa e personelit te kualifikuar ne sektorin e arsimit dhe ambjenteve ku zhvillohet procesi mesimor.(e)- Edhe pse ka bollek te burimeve ujore problem mbetet furnizimi me uje I popullsise ne te gjitha zonat e banuara.(f)-Edhe pse nuk mungojne produktet cilesore si ato

bujqesore dhe blektorale problem mbetet shitja e tyre pasi nevojat e popullsis se qytetit te Çorovodes jane te vogla ne raport me sasin e ofruar te tyre.Transporti drejt qendrave te tjera konsumatore do te sillte rritje te kosos dhe paleverdisherin te prodhuesit.Industria e perpunimit te produkteve blektorale si dhe e perpunimit sidomos te frutave do rriste ndjeshem interesin e fermereve per te rritur prodhimin ne keto produkte.

3.Projektet kryesore te PBA-së 2019-2021

Ng ate dhenat e PPV te bashkise Skrapar projektet prioritare ne planin e Investimeve jane si me poshte.

PROJEKTET PRIORITARE		Ne Euro					
NR.	PROJEKTI/AKTIVITETI/NDERHYRJA	VLERA TOTALE	2017	2018	2019	2020	2021
1	Ndertim,permirsim I aksit turistik Çorovde-Permet	16,883,615	5,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000	2,883,615
2	Ndertim,permirsim I aksit turistik Çorovde-Gramsh	49,151,425	10,000,000	10,000,000	10,000,000	10,000,000	9,151,425
3	Ndertim ,permiesim I aksit Rrugore Çorovode-Korçe	16,901,780	5,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000	2,901,780
4	Permirsimi Rrjetit Rrugor Rural	3,250,000	1,000,000	750,000	500,000	500,000	500,000
5	Ndertimi rruges ne gjatesin e lumit te Tomorrices	270,000	70,000	50,000	50,000	50,000	50,000
6	Percaktimi strategjise Turizmit mbrojtjene Trashg.Kulturore	300,000	75,000	75,000	75,000	50,000	25,000
7	Krijimi pikave per grumbullimin e prodhimit blektoral	261,584	60,000	50,000	50,000	50,000	51,584
8	Promovimi I prodhimit bujqesor vendas	5,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
9	Ndertimi I rrjetit te ri te KUZ dhe impjanti perpunimit te Ujrave te zeza	8,000,000		2,000,000	3,000,000	2,000,000	1,000,000
10	Krijimi zones ekonomike te biznesit	800,000	200,000	200,000	150,000	150,000	100,000
11	Ndertimi vendeve te pushimit dhe ofrimit te sherbimeve ndaj vizitoreve	100,000	25,000	25,000	20,000	20,000	10,000
12	Studimi per menaxhimin e mbetjeve te ngurta ne nivel qarku	1,500,000	500,000	300,000	300,000	250,000	150,000
13	Ndertim Landfilli	250,000	100,000	50,000	50,000	25,000	25,000
		97,673,404	22,031,000	19,501,000	20,196,000	19,096,000	16,849,404

Si vihet re dhe nga pasqyra e mesiperme e projekteve prioritare ndertimi dhe permirsimi I akseve rugore qe lidhin bashkin tone me Permetin,Korçen,Gramshin do te jepnin nje impakt pozitive ne ekonomin e zones pasi do krijoheshin mundesi te reja per fermeret qe te shesin produktet bujqesore dhe blektorale te zones te cilat munde te jene konkruense ne rajon.Po ashtu ndikim pozitive do te kishte edhe ne lidhje shtimin e numrit te turistev vendas dhe te huaj te cileve u krijohen mundesi te reja per te ardhur me shpejte dhe me shpeshe ne zonat atraktive te bashkise Skrapar.Po ashtu krijimi pikave per grumbullimin e produkteve blektorale,promovimi I prodhimit bujqesor dhe blektoral,ndertimi vendeve te pushimit dhe ofrimi sherbimeve ndaj vizitoreve,do te nxise fermeret per te rritur kapacitetet prodhuese ne bujqesi dhe blektori,investimet qe parashikohen per menaxhimin e mbetjeve dhe ndertimin e landfilleve do ti kontribuojne nje mjedisi te pastes dhe te kendshem per turiset dhe vizitoret e ndryshem.

3.2 –Plani shpenzimeve kapitale /projektplani 2019-2021(ME FONDET E BASHKISE)

(F15) SHPENZIMET KAPITALE			2016	2017	2018	2019	2020	2021	
Nr									
1	Programi 1	011	Organet ekzekutive dhe legjislative,Çeshtjet financjare dhe fiskale,Çeshtjet e Brendeshme	12,331	5,428	10,823	7,215	7,715	7,214
2	Programi 2	013	Sherbime te Pergjithshme						
3	Programi 3	031	Sherbimet e Policise						
4	Programi 4	032	Sherbimet e mbrojtjes nga zjarri			7,200			
5	Programi 5	036	Rendi publik dhe masat e sigurise						
6	Programi 6	041	Çeshtje te pergjithshme ekonomike,tregetare dhe te punes						
7	Programi 7	042	Bujqesia,Pyjet,Peshkimi dhe Gjuetia	22,950	36,060	9,510			
8	Programi 8	045	Transporti	176,588	59,182	28,573	30,977	36,701	34,848
9	Programi 9	047	Industri te tjera						
10	Programi 10	051	Menaxhimi mbetjeve						
11	Programi 11	052	Menaxhimi ujrave te zeza						
12	Programi 12	053	Reduktimi ndotjes						
13	Programi 13	056	Mbrojtja e mjedisit						
14	Programi 14	061	Zhvillimi strehimit						
15	Programi 15	062	Zhvillimi komunitetit	9,255	14,170	6,000			
16	Programi 16	063	Furnizimi me uje						
17	Programi 17	064	Ndriçimi rrugëve						
18	Programi 18	072	Sherbimet Ambulatore						
19	Programi 19	081	Sherbimet rekreative dhe Sporti						
20	Programi 20	082	Sherbime kulturore			2,200			
21	Programi 21	091	Arsimi baze dhe parashkollot	744	423	5,438	4,000	6,000	6,500
22	Programi 22	092	Arsimi mesem	1,936		2,233	681	954	954
23	Programi 23	096	Sherbime plotesuese ne arsim						
24	Programi 24	101	Semundje dhe paaftesi						
25	Programi 25	102	Te moshuarit						
26	Programi 26	104	Familje dhe femije						
27	Programi 27	105	Papunesia						
28	Programi 28	106	Strehimi						
29	Programi 29	107	Ndihma ekonomike						
			TOTALI	223,804	115,263	71,977	42,873	51,370	49,516

Ne shpenzimet per investime te viteve 2016,2017,perfshihen dhe fondet e çelura nga F.ZH.R dhe nga buxheti shtetit ndersa per vitet 2019,2020,2021 jan parashikuar vetem shpenzimet per investime nga transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e planifikuara te bashkise sipas viteve perkatese.Si shihet dhe nga pasqyra e mesiperme pjesa me e madhe e investimeve eshte planifikuar per rikonstruksionin e rrugëve dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore arsimit 9 vjeçar.Kerkesat per investime ne keto programe buxhetore jane te medha ndersa mundesit nuk jane premtuese.Vetem rruget qe lidhin qytetin me qendrat e njesive administrative arrijne ne 180 km te cilat kane nevojë per rikonstruksione dhe mirmbajtje pasi dhe terreni malore dhe dimri me rreshje l demton shume keto sekmente rrugore.Po ashtu dhe ndertesat shkollore qe jane shum ne numer per arsye te numrit te madh te fshatrave ne teritorin e bashkise Skrapar jan ne gjendje jo te mire me kushte te papaershtateshme per zhvillimin e procesit mesimor,prandaj me planifikimin e fondeve modeste per mirmbajtje dhe rikonstruksione synohet permirsimi i kushteve per zhvillimin normal te procesit mesimor.Si vihet re dhe ne pasqyren (F14) shpenzimet per investime zene nje peshe te vogel ne krahasim me totalin e shpenzimeve perkatesishte ne vitin 2019 =13.55,ne vitin 2020 =15.6% dhe ne vitin 2021 =14.3%.edhe pse vihet re nje tendence ne rritje kjo nuk eshte e mjaftueshme per plotesuar nevojat per investime ne programe te ndryshme buxhetore.Nje nga synimet e reformes administrative-teritoriale ishte

pakesimi shpenzimeve korrente ne zerin (paga sigurime shoqerore) duke pakesuar numrin e punonjesve te panevojshem sidomos ne njesit administrative.Ky eshte nje synim I parealizuar dhe ne bashkine tone edhe pse eshte bere nje pune e mire ne shfrytezimin e burimeve njerezore perseri ka vende per pakesim te numrit te punonjesve sidomos ne njesit administrative qe ne teritorin e bashkise tone jane 8.Edhe sipas orientimit te dhene per vitin 2018 e me pas Keshilli Bashkise ka kompetencen per te reduktuar numrin e njesive administrative nisur dhe nga numri vogel I popullsise sidomos ne disa prej tyre.Kjo do te bente te mundur permirsimin e situates financjare dhe rritjen e fondeve te investimeve.Komuniteti ka nevojte per tu ofruar shëbimet e duhura ne kohen dhe cilesin e duhur ky eshte treguesi performances se nje bashkie dhe jo numri I te punesuarve pasi bashkia eshte nje institucion ku ligji I ngarkon te permirsoj shëbimet sipas funksioneve te percaktuara dhe punesimi .Ne lidhje me numrin e punonjesve duhet qe te vendosen disa kriteret te cilat te parcaktojn nje kufi mbi te cilin te mos lejohet shtimi numrit te punonjesve.

4.Informacion financiar

4.1Supozimet e planifikimit

Treguesit e rritjes ekonomike varen bga rritja e fondeve buxhetore nga te gjitha burimet,Transferta e Pakushtezuar,Transferta Specifike,te Ardhurat e Planifikuara,Fondet e Deleguara ,Fondet e çelura nga buxheti per investime.Rritje ka vetem ne nivelin e transfertes pakushtezuar e cila per vitin 2021 ka ne efekt pozitive me te madh ne krahasim me vitet e mepareshme.Transferta specifike eshte ne te njejtin nivel,nuk kemi te dhena per fondet per funksionet e deleguara si dhe per akordimin e fondeve per projekte investimesh te miratuara ne PPV te bashkise Skrapar.Burimet nga gjenerohej pjesa me e madhe e te ardhurave te vete bashkise,jane nje pikpyrtje e madhe pasi nese qeveria vendos mbylljen e guroreve dhe nxjerrjen e mermerit plani te ardhurave munde te rishikohet dhe munde te ulet ne nivelin deri 40% te planit aktual (plani per vitin 2018),kjo de te perbente nje problem per realizimin e buxhetit sidomos ne zerat paga dhe sigurime pasi te ardhurat e planifikura zene nje pjese te konsiderueshme ne kete ze buxhetor.

4.2 Burimi te ardhurave

		2016	2017	2018	2019	2020	2021
		Viti t-2	Viti t-1	Viti t	Viti t+1	Viti t+2	Viti t+3
A	TE ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	95,394	97,451	100,000	107,577	110,277	114,157
A.1	TE ARDHURAT NGA TAKSAT LOKALE	36,520	13,185	11,099	11,209	11,424	12,644
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogel	580	633	665	680	720	740
A.1.2	Taksa mbi pasurin e palujteshme	15,335	11,046	9,118	9,724	9,899	11,000
A.1.2.1	Taksa mbi ndertesën	4,827	4,156	3,531	5,100	5,150	5,200
A.1.2.2	Taksa mbi token bujqesore	9,392	5,634	4,028	4,000	4,100	4,200
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	1,116	1,116	1,409	550	560	1,500
A.1.2.4	Taksa		140	150	74	89	100
A.1.3	Taksa vendore ne sherbimin hotelier	227	204	205	205	205	204
A.1.4	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	18,772	261	100	100	100	100
A.1.5	Taksa e tabelës	1,606	1,041	1,011	500	500	600
A.1.6	Taks vendore mbi te ardhurat nga dhuratat, trashëgimi, testament, dhe llotarite vendore						
A.1.7	Taksa e perkoheshme (a)						
A.1.8	Taksa e perkoheshme (b)						
A.1.9	Taksa e perkoheshme (c)						
A.2	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)	2,732	3,174	3,290	4,957	5,007	5,220
A.2.1	Taksa mbi kalimin e drejtes se pronesise/pasuri e palujteshme						
A.2.2	Taksa vjetore e qarkullimit te mjeteve te perdorura	2,512	2,622	2,470	2,500	2,500	2,560
A.2.3	Taksa e rentes minerare	220	552	600	700	750	750
A.2.4	Taksa mbi te ardhurat personale			220	220	220	220
A.2.5	Taksa te tjera				1,537	1,537	1,690
A.3	TE ARDHURA NGA TARI FAT VENDORE	25,263	28,244	28,954	48,360	51,119	51,346
A.3.1	Tarifa e menaxhimit te mbetjeve	7,050	5,421	5,700	6,500	6,600	6,700
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit per familjet	2,678	3,032	3,200	3,648	3,704	3,760
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit per institucionet	2,025	571	600	684	695	705
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit per biznesin	2,347	1,818	1,900	2,168	2,201	2,235
A.3.2	Tarifa per mbledhjen dhe largimin e mbetjeve						
A.3.3	Tarifa per ndricimin publik	1,453	1,384	1,385	1,475	1,480	1,482
A.3.3.1	Tarifa per ndricimin publik nga familjet	650	702	700	746	748	749
A.3.3.2	Tarifa per ndricimin publik nga institucionet	230	230	232	247	248	248
A.3.3.3	Tarifa per ndricimin publik nga bizneset	573	452	453	482	484	485
A.3.4	Tarifa per gjelberimin	982	757	753	870	890	890
A.3.4.1	Tarifa per gjelberimin nga familjet	402	287	290	335	343	343
A.3.4.2	Tarifa per gjelberimin nga institucionet	220	220	220	254	260	260
A.3.4.3	Tarifa per gjelberimin nga biznes	360	250	243	281	287	287
A.3.5	Tarifa per sherbimet administrative te bashkise	9,608	12,537	11,147	20,761	22,931	23,056
A.3.5.1	Tarifa per sherbimet administrative te bashkise	349					
A.3.5.2	Tarifa per dhenien e licencave, lejave dhe autorizimeve						
A.3.5.3	Tarifa te kontrollit te zhvillimit te territorit						
A.3.5.4	Tarifa per vulosjen veterinare te bagetive te therura	1,036	805	524	1,100	1,100	1,100
A.3.5.5	Tarifa e licencimit te veprimtarive te transportit	202	274	220	264	263	263
A.3.5.6	Tarifa e parkimit per mjetet e licencuara dhe vendparkimet publike	941	820	424	1,017	1,068	1,068
A.3.5.7	Tarifa e dhenies se licences per tregetin e naftes bruto dhe nenproduktet e saj	2,000	1,043				
A.3.5.8	Tarifat per pyjet dhe kullotat	3,366	8,889	9,280	16,000	18,000	18,000
A.3.5.9	Tarifa per sherbimet shtese nga zjarrfiksj						
A.3.5.10	Tarifa per zenien dhe perdorimin e hapësirave publike dhe fasadave	1,714	706	699	2,380	2,500	2,625
A.3.5.11	Tarifa per trajtimin e mbetjeve inerte ne landfille						
A.3.5.12	Tarifa per linjat ajerore dhe nentoksore (Telefon, Energji, TV Kablor, Internet)						
A.3.5.13	Tarifa per dokumentat per tenderat, ankandet etj.						
A.3.6	Tarifa te institucioneve te arsimit, kultures, sportit etj	2,753	2,445	2,090	2,389	2,458	2,458
A.3.6.1	Biblotekat						
A.3.6.2	Muzeumet						
A.3.6.3	Teatri						
A.3.6.4	Qendra Kulturore e Femijve	18		20	30	30	30
A.3.6.5	Pallati Sportit						
A.3.6.6	Qendra Komunitare						
A.3.6.7	Mensa (Konviktete)	1,815	1,400	1,250	1,375	1,444	1,444
A.3.6.8	Kopshtet						
A.3.6.9	Çerdhet	920	1,045	820	984	984	984

A.3.7	Tarifa per furnizimin me uje dhe kanalizime						
A.3.8	Tarifa per sherbimin e ujitjes dhe kullimit						
A.3.9	Tarifa te perkohshme(Tarif per kalimin e mjeteve te tonazheve te renda)				3,207	3,207	3,207
A.3.10	Tarifa te tjera	3,417	5,700	7,879	13,158	13,553	13,553
A.4	TE ARDHURA TE TJERA	30,879	52,848	56,657	43,051	42,727	44,947
A.4.1	Qiraja nga asetet ne pronesi te bashkise	14,159	18,909	14,320	34,271	34,700	36,000
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale						
A.4.3	Fitimi nga ndermarrjet publike ne varesi te bashkise	522	646	520	470	471	470
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat						
A.4.5	Terheqje te ardhurave krijuar nga sherbimet						
A.4.6	Shitja e mallrave dhe sherbimeve						
A.4.7	Kundravajtjet administrative(Gjobat)			120	200	200	200
A.4.8	Sekuestime dhe Zhdemtime	3					
A.4.9	Kuatat e anetarsise te bashkive						
A.4.10	Transferta dhe ndihma nga njesit e tjera vendore						
A.4.11	Grante dhe ndihma nderkombetare	366	278	300			
A.4.12	Shitja e asetave financjare						
A.4.13	Shitja e asetave fikse te perkohshme /paprekshme						
A.4.14	Te tjera	15,829	33,015	41,397	8,110	7,356	8,277
B	TE ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	434,222	324,535	258,286	219,262	228,110	240,826
B.1	TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	109,321	151,145	116,888	119,551	128,399	141,115
B.2	TRANSFERTA E KUSHTEZUAR	235,626	0	0	0	0	0
B.2.1	Per funksionet e deleguara						
B.2.2	Per projekte te vencanta (FZHR e te tjera)	235,626					
B.3	TRANSFERTA SPECIFIKE	76,394	92,321	99,711	99,711	99,711	99,711
C	HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0
C.1	HUAMARRJA AFATSHKURTER						
C.2	HUAMARRJE AFATGJATE						
D	TRASHEGIMI NGA VITI SHKUAR	12,881	81,069	41,687	0	0	0
D.1	TRASHEGIM PA DESTINACION	12,881	8,000	26,541			
D.2	TRASHEGIM ME DESTINACION		73,069	15,146			
	TOTALI BURIMEVE BUXHETORE	529,616	421,986	358,286	326,839	338,387	354,983

Analize per parashikimin e te ardhurave per periudhen 2019-2021(faktoret e rritjes ose uljes se nivelit te mbledhjes taksave dhe tarifave)

Ne parashikimin e te ardhurave per periudhen afatmesem 2019-2021 eshte mbeshtetur ne ligjin Nr 9632 , date 30.10.2006 " Per taksat vendore' i ndryshuar ,ne VKB Per paketen fiskale te vitit 2018, politikat fiskale qendrore dhe lokale , ne projektet e zhvillimit social ekonomik , resurset natyrore te rrethit, sidomos ne pritshmerite positive te zhvillimit te turizmit dhe bujqesise si fusha prioritare ne zhvillimin e zones ne te ardhmen e afert dhe te larget ,si dhe realiimin e te ardhurave te vitit 2017 dhe 2018, sidomos realizimi i vitit 2018 si vitit me i stabilizuar fiskal.

Te ardhurat nga burimet e veta jane parashikur te rriten me 2.5 % per vitin 2019 ne krahasim me te pritshmin e vitit 2018 ndersan ne vitet 2020 ,2021 kemi nje rritje perkatesisht 2.5 dhe 3.5 % ne krahasim me vitin paseardhes..Ne total per vitin 2021 parshikohen 114.157 000 leke nga 97.451 000 leke te realizuar vitin 2018 me nje diference + 16 706 000 leke .

Rritje do te pesojene te ardhurat nga taksa per ndertesat nga 4 156 mije ne 5 2000 mije leke ne vitin 2021 .Kjo rritje do te vije evidentimi i sakte i ndertesave ne pronesi te bizneseve dhe ato te banimit , krijimit te kadastres fiskeale dhe ndryshimit te ligjit duke bere taksimin mbi vleren e ndertesave.

Me rritje parashikohen edhe zetat e tarifave per pastrimin , ndricimin dhe gjelberimin per familjaret dhe bizneset.. krijimi i kadastres fiskale do te beje te mundur saktesimin e gjith familareve dhe bizneseve ne bashki , si dhe

nepermjet permiresimit te tarifave perkatese duke krijuar nje diference te arsyeshme midis te ardhurave dhe shpenzimeve per keto sherbime. Deri tani disniveli eshte shume i madh dhe nga viti 2012 nuk ka ndryshime te tarifave me gjith permiresimin e sherbimit ne kete fushe.

Rritjete ardhurave parashikohen ne sektorin e pyjeve dhe kullotave deri ne 18 milion ne v.2021.Pjesa me e madhe e siperfaqes se bashkise mbulohet nga pyjet dhe kullotat .ne kete sektor ka rersuse ne prodhimin dhe perpunimin e gurit pllakor gelqeror, te remeritr, dhe shfrytezimit te pasurise ujore ne prodhimin e energjise elektrike nga HEC –et. Menaxhimi me i mire i fondit kullosor , dhenia e tyre me qira eshte nje mundesi e mire ne rritjen e te ardhurave. Politikat e bashkise ne drejtim te rritjes se turizmit ,reklamimi i bukurive natyrore sidomos te lugines se Oumit dhe jo vetem , do te beje te mundur rritjen e numurit te turisteve dhe kerkesave tyre,do te kete impact pozitiv ne drejtim te rritjes se te ardhurave nepermjet zhvillimit te bizneseve, permiresimit te sherbimit, si dhe rritja prodhive bujqesore dhe blektorale ne fuksion te tij.

Faktor negativ ne te ardhurat afatmesem eshte tendeca e largimit te popullsise te zonave te thella , e cila deri tani ka qene shume dukshme deri ne shpopullim te fshatrave te tere, fenomen qe ka prekur edhe qytetine Corovodes si dhe largimi I moshes se re ,dhe mos kthimi i studenteve qe mbarojne studimet e larta. Per minimizimin e ketij fenomeni nga bashkia ne te ardhmen jane parashikur permiresimi i sherbimit ne infrstrukturen rrugore, arsim shendetesi , zhvillimi i turizmit etj, me qellim stabilitetin e popullsise banuse dhe rritjes e popullsise me banim zezional ne keto zona si dhe permiresimin e kushteve.

Faktor me ndikim negative eshte infrstruktura e keqe rrugore, rruga nacionale Corovode Berat eshte e amortizuar , ndersa rruqet e tjera rruale qe lidin qendreat administrative me bashkine jane jasht cdo standarti. Levizja e njerzve dhe mallrave kerkon kohe te gjate , edhe ditore, nga prodhuesi te konsumatori , per pasoje rrit shume koston e biznesit. Permiresimi I sistemit rrugor kerkon fonde nga qeveria qendrore.

Rritja e te ardhurave do shoqerohet me permiresimin e punes se bashkise ne drejtim te : promovimit dhe mbeshtetjes se biznesit,permiresimin e infrstruktures se nevojshme per rritjen e biznesit , zgjerimit te bazes se taksueshme te bizneseve, familjareve dhe fermereve, vleresimi real I detyrimeve te taksapaguesve, njoftimi ne kohe, transparencja dhe menaxhimi I mire I te ardhurave. Rendesit e vecante do ti kushtohet hapjes se bizneseve te reja duke I dhene asistence dhe keshillim nga administrate tatimore , orientim ne fushat prioritare dhe fitimprures ne zhvillimin e biznesit, njohja me resuset ekonomike te zones , nevojave per biznese te reja etj.

4.3-Shpenzimet

		(F6) SHPENZIMET E PËRGJITHSHME																	
		2016			2017			2018			VITI 2019			VITI 2020			VITI 2021		
		W/I-1-2	W/I-1-1	W/I-1-1	PAGA SAGJORL	SHP. OPERAT	INVES TIME	TOTAL SPENZ	PAGA SAGJORL	SHP. OPERAT	INVES TIME	TOTAL SPENZ	PAGA SAGJORL	SHP. OPERAT	INVES TIME	TOTAL SPENZ			
Programi 1	011	Org. ekz. dhe legji.,Ç. Finan. dhe fiskale,Ç.Brend.	74,918	89,925	90,177	46,054	25,750	7,215	79,029	46,054	25,620	7,715	79,389	46,055	25,470	7,214	85,929		
Programi 2	013	Sherbime te Pergjithshme	19,867	33,824	18,234	10,912	800		11,712	10,911	900		11,811	10,911	1,200		12,061		
01-Sherbime te pergjithshme publike		94,785	108,549	108,411	56,966	26,560	7,215	90,741	56,965	26,520	7,715	91,200	56,966	26,620	7,214	101,000			
Programi 3	031	Sherbimet e Policise	3,000	3,051	3,168	2,917	250		3,187	2,918	250		3,188	2,918	250		3,188		
Programi 4	033	Sherbimet e mbrojtjes nga djami	9,265	13,967	23,329	13,842	2,387		18,129	13,842	2,387		18,129	13,842	2,387		18,129		
Programi 5	036	Bendi publik dhe masat e sigurise																	
03-Rendi dhe Siguria Publike		12,281	17,018	26,497	16,759	2,537	0	19,296	16,760	2,587	0	19,297	16,760	2,587	0	19,297			
Programi 6	041	Çeshtje te pergjithshme ekonomike, tregetare																	
Programi 7	042	Buzgese,Pyjet,Peshkimi dhe Gjuetia	31,770	52,804	29,317	13,160	10,285		23,445	13,160	10,315		23,475	13,160	10,345		23,505		
Programi 8	045	Transporti	188,538	71,518	48,653	11,161	1,405		10,977	43,743	11,162	1,405	36,701	49,448	11,161	1,405	34,888		
Programi 9	047	Industri te tjera	2,014	2,067	2,117	1,867	359		2,187	1,867	359		2,217	1,867	400		2,267		
04-Ceshtjet Ekonomike		222,322	126,209	80,087	26,388	11,990	30,977	69,359	26,389	12,070	36,701	75,160	26,388	12,150	34,848	78,384			
Programi 10	051	Menaxhimi mbretjeve	15,165	16,090	17,769	12,545	3,000		17,545	12,545	6,000		18,545	12,545	6,500		19,045		
Programi 11	052	Menaxhimi urave te zeza																	
Programi 12	053	Reduktimi ndotjes																	
Programi 13	056	Mbrojtja e mjedistit																	
05-Mbrojtja Mjedisore		15,165	16,090	17,769	12,545	3,000	0	17,545	12,545	6,000	0	18,545	12,545	6,500	0	19,045			
Programi 14	061	Zhvillimi shtrimit																	
Programi 15	062	Zhvillimi komunitetit	28,182	31,867	27,306	12,370	14,900		27,270	12,370	15,000		27,370	12,370	21,500		31,920		
Programi 16	063	Familjari me uje																	
Programi 17	064	Ndriqimi rrugëve	5,850	4,240	6,075	934	5,400		6,334	934	6,250		7,184	934	7,000		7,934		
06-Strahimi dhe Lehtësitë e Komunitetit		82,037	88,107	83,381	13,304	20,300	0	38,604	13,304	21,250	0	34,554	13,304	28,550	0	41,854			
Programi 18	072	Sherbimet Ambulatore																	
07-Shëndetësi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
Programi 19	081	Sherbimet rekreative dhe Sporti	1,720	1,771	2,521	2,217	900		2,757	2,217	900		3,717	2,217	900		2,717		
Programi 20	082	Sherbime kulturore	4,700	5,124	6,050	3,734	900		4,234	3,734	900		4,234	3,734	900		4,234		
08-Argetimi, Kultura dhe Ceshtjet Fetare		6,426	6,895	8,571	5,951	1,000	0	6,991	5,951	1,000	0	6,951	5,951	1,000	0	6,951			
Programi 21	091	Anisimi bace dhe parashkolliot	41,040	47,921	51,689	42,519	4,289		4,000	50,808	42,519	4,789	6,000	51,308	42,519	4,789	6,500		
Programi 22	092	Anisimi mesem	15,960	14,863	20,932	15,016	4,378		681	20,075	15,016	4,828	954	20,798	15,016	4,978	954		
Programi 23	096	Sherbime plotesuese ne anisim																	
09-Anisimi		57,000	62,584	72,621	57,535	8,667	4,681	70,863	57,535	6,617	6,954	74,106	57,535	9,767	7,454	74,754			
Programi 24	101	Semundje dhe paafesi	1,651	2,251	2,576	1,984	600		2,584	1,984	650		2,634	1,984	700		2,684		
Programi 25	102	Te moshuarit																	
Programi 26	104	Familje dhe femije	4,280	4,836	4,991	3,734	1,300		4,934	3,734	1,250		4,984	3,734	1,300		5,034		
Programi 27	105	Papunesia																	
Programi 28	106	Strahimi																	
Programi 29	107	Ndihma ekonomike	2,594	2,697	2,726	2,626	170		2,796	2,626	180		2,806	2,626	200		2,824		
10-Mbrojtja Sociale		8,525	9,844	10,343	8,344	1,970	0	10,314	8,344	2,060	0	10,424	8,344	2,200	0	10,344			
TOTALI		448,546	380,300	356,236	197,792	78,024	42,873	318,669	197,738	81,074	51,370	330,287	197,795	90,524	49,516	346,833			

Si vihet re dhe nga pasqyra e mesiperme shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore jane ne nivel konstant,po ashtu dhe shpenzimet per investime,ndersa niveli shpenzimeve operative ka nje rritje nga 78.024.000 leke ne vitin 2019 ne 81.074.000 leke ne vitin 2020 dhe ne 99.524.000 leke ne vitin 2021.

-Pra e gjith rritja e trasnfertes pakushtezuar eshte menduar te shkoj per shpenzime operative pasi nje arsye eshte parashikimi I shlyerjes se detyrimeve te prapambetura brenda kesaj periudhe.Gjithashtu dhe shtrija e sherbimeve te pastrimit, menaxhimit te mbetjeve, ndricimit publik edhe ne disa fshatra me profil turistik si dhe ne qendrat e njesive administrative rrit kerkesen per fonde nga shpenzimet operative.

-Numri konsiderueshem I ambjenteteve shkollore qofshin keto ne pronesi te bashkise apo te mara me qera rrit nevojën per fonde per mirmbajtjen dhe llyerjen si dhe pagesen e qirase per objektet e mara me qira .Synimi eshte qe brenda keti program buxhetor bashkia te kete shlyer te gjitha detyrimet e parapambetura kjo do te beje te mundur qe me pase duke bere nje planifikim sa me real te evitojme krijimin e detyrimeve te reja duke rritur performancen menaxhuese te burimeve financjare.

-Shpenzimet per investime ne raport me totalin e shpenzimeve gjithsej ne vitin 2019 jane parashikuar 13.5%,ne vitin 2020 jane parashikuar 15.6% dhe ne vitin 2021 jane parashikuar 14.3%,edhe pse ka nje tendence rritjeje kjo nuk mjafton per te plotesuar kerkesat e shumta per investime sidomos ne infrastrukturen rrugore,rrjetin e uites dhe kullimit,rikonstruksione te objekteve shkollore.

-Shpenzimet operative ne raport me totalin e shpenzimeve per vitin 2019 jane parashikuar 24.4%,ne vitin 2020 jane parashikuar 24.6% dhe ne vitin 2021 jane parashikuar 28.7%, pra ne vitin 2021 kemi nje rritje te ndjeshme te shpenzimeve operative me te cilen synojme plotesimin e kerkesave per keto shpenzime dhe funksionimin normal te aktivitetit te bashkise ne funksionet ku jane parashikuar keto shpenzime.Theksojme se kjo rritje do beje te mundur likujdimin e detyrimeve te prapambetura dhe pakesimin e riskut per krijimin e detyrimeve te reja.

-Shpenzimet e personelit ne raport me totalin e shpenzimeve per vitin 2019 jane parashikuar 62.1%, ne vitin 2020 jane parashikuar 59.9%, dhe ne vitin 2021 jane parashikuar 57%.Edhe pse vihet re nje ulje e shpenzimeve te personelit kjo vjen si rezultat i rritjes buxhetit nga 2019-2021 pasi ne vler absolute keto shpenzime jane te njejta.Keto nivele flasin qarte se shpenzimet per paga dhe sigurime zene me teper se gjysmen e shpenzimeve te buxhetit.Edhe pse ky nivel vjen si rezultat i transferimit te funksioneve te reja te bashkites per te cilat pothuajse 90% e buxhetit eshte i destinuar per paga dhe sigurime, perseri ka vend per tu pare ne lidhje me shpenzimet e personelit duke menduar uljen e tyre ,kjo do te çlironete shum fonde buxhetore per ti perdorur sidomos per investime.

4.4-Rezultati total I buxhetit.

Burimet e pergjithshme te buxhetit sipas viteve jane perkatesishte:

Burimet	Shpenzimet	Diferenca ne 000/leke
Viti 2016 =592.616	448.546	81.070 Te ardhura te paperdorura trasheguar per vitin 2017
Viti 2017 =421.986	380.300	41.686 Te ardhura te paperdorura trasheguar per vitin 2018
Viti 2018 =358.286	358.286	0
Viti 2019 =326.839	318.689	8.150 Fondi Rezerve +Kontigjenca
Viti 2020 =338.387	330.237	8.150 Fondi Rezerve +Kontigjenca
Viti 2020 =354.983	346.833	8.150 Fondi Rezerve +Kontigjenca

Buxheti ne total eshte i balancuar pra burimet e te ardhurave jane te barabarta me shpenzimet e planifikuara, diferenca per vitin 2016 ka ardhur si rezultat i çeljes se disa projekteve te investimeve ne funde te periudhes buxhetore dhe qe e pamundur te zhvilloheshin procedurat e prokurimit te ketyre fondeve ne 2017 kane si pasoje e vendosjes se cash limitit ne muajin nentor dhe dhjetor nga Ministria e Financave.Per keto dy vite buxhetore ka pasur nje perputhje te burimeve te pergjithshme me shpenzimet e pergjithshme. Realizimi te ardhurave te planifikuara ne keto dy vite 2016,2017 ka qene afersishte 100% gje qe tregon per planifikim real mbi baza te dhenash te sakta ,kjo ka beret e mundur dhe realizimin e shpenzimeve te pergjithshme sipas parashikimit.Per tre vitet e ardhshme buxhetore risku per mosrealizimin eshte me i larte pasi disa aktivite nga te cilat gjeneroheshin te ardhura u eshte pezulluar aktiviteti(nxjerrja e pllakave te gurit, dhe mermerit).Gjithsesi eshte menduar qe pas marjes se nje vendimi perfundimtar nga qeveria te bejme rishikimin e buxhetit ne teresi duke ulur shpenzimet per paga dhe sigurime (personelit)si dhe duke kerkuar shtese buxheti nga fondi reserve I qeverise.

4.4-Informacion financiar suplementar

4.4.1-Huamarrje

Bashkia Skrapar nuk ka aplikuar metodat e financimit me hua apo kredi pasi e sheh te arsyshme te mos riskoj ne kete drejtim. E vetmja arsye qe mund te na conte ne keto metoda financimi kane qene detyrimet e prapambetura.Por me nje planifikim dhe menaxhim te mire te burimeve mendojme se brenda kesaj periudhe buxhetoredo ti shlyejme te gjitha detyrimet e prapambetura.

4.4.2-Detyrimet e prapambetura

-Bashkia Skrapar ka trasheguar nje vlere te konsiderueshme detyrimesh te prapambetura nga ish komunit si kontrata te realizuar e te pafinancuara detyrime permbarimore,detyrime te energjise elektrike, poer dhe detyrime per kontratat e realizuara port e pafinancuara nga FZHR.Ne total detyrimet e prapambetura gjendje 31.12.2015 kane qene 80.901.346 leke – 44.996.493 leke detyrime te FZHR =35.904.853 leke.Detyrime gjendje 31.12.2017 kane qene 93.773.865 leke duke zbritur 44.996.493 leke =48.777.372 leke. Jane shlyer detyrime gjat keti viti te gjitha faturat e pafinancuara per shkak te vendosjes se Cash Limitit nga Ministria e Financave,si dhe detyrime te tjera permbarimore detyrime te prapambetura gjendje 31.05.2018, rezultojne ne vleren 24.718.000 leke nga te cilat vendimet gjyqesore jane ne vleren 10.425.000 leke , detyrime energjie ne vleren 11.527.000 leke dhe detyrime ndaj sh.a ujsjellesit 2.189.000 leke.

4.4.3-Treguesit Financjar

(F14) TRGUESIT FINANCIAR	2016	2017	2018	2019	2020	2021
1 Norma e totalit te shpenzimeve ndaj totalit te te ardhurave	në %					
Shpenzimet e pergjithshme /Te ardhurave te pergjithshme	84.7	90.1	100.0	97.5	97.6	97.7
2 Norma e te ardhurave nga taksat dhe tarifat ndaj totalit te te ardhurave	në %					
Taksa dhe tarifa lokale/Te ardhurave te pergjithshme	11.7	9.8	11.2	18.2	18.5	18.0
3 Norma e te ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit te te ardhurave	në %					
te ardhurat nga burimet e veta /te ardhurat e pergjithsme	18.0	23.1	27.9	32.9	32.6	32.2
4 Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit te shpenzimeve	në %					
Shpenzime kapitale / Shpenzime te pergjithshme				13.5	15.6	14.3
5 Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve rotale	në %					
Shpenzime korrente/shpenzime totale				86.5	84.4	85.7
6 Norma e shpenzimeve te personelit ndaj totalit te shpenzimeve	në %					
Shpenzime personeli /shpenzime totale				62.1	59.9	57.0
7 Norma e huamarrjes afatgjate ndaj totalit te ardhurave	në %					
Huamarrja /Totalit te ardhurave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
8 Norma e huamarrjes afatgjate ndaj te ardhurave te veta	në %					
Huamarrja /Atdhurat e veta	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
9 Norma e detyrimeve te vonuara ndaj totalit te te ardhurave	në %					
Detyrimet e vonuara /Totali te ardhurave	6.2	0.0	4.0	31.4	0.0	10.4
9 Norma e shpenzimeve ne politikat sociale ndaj totalit te shpenzimeve	në %					
Shpenz.politikat sociale /Totali shpenzimeve	1.9	2.6	2.9	3.2	3.2	3.0

Ng ate dhenat e pasqyres mesiperme shohim ka nje diference midis shpenzimeve te pergjithshme dhe te ardhurave te pergjithshme,domosdoshmerishte buxheti hartohet l balancuar pasi planifikohen burimet e te ardhurave dhe pastaj shpenzimet.Diferenca sidomos me dy vitet e meparshme vjen si pasoj e pamundesise financimit te fondeve te çelura me VKM ne funde te periudhes buxhetore 2016 ndersa ne vitin 2017 Ministria e Financave dhe Ekonomise vendosi limitim te shpenzimeve ne periudhen nentor dhjetor per arsye te mungeses likuiditeteve ne CASH.Diferenca ne 2019-2021 eshte fondi reserves dhe kontigjences l planifikuar per keto vite buxhetore.

Norma e te ardhurave nga taksat e tarifat vendore ne krahasim me te ardhurat gjithsej ka nje renie ne vitin 2017,ne vlere relative sepse fondet buxhetore kete vit kane qene me te medha,ndersa ne vitet 2019-2021 duket se ka nje rritje ne % por ne vlere absolute eshte e nje rritje e vogel sipas tabelës parashikimit te ta ardhurave. Ne vitin 2016 raporti eshte $61.783/529.616=11.7\%$,ne vitin 2017 raporti eshte $41.429/421.986=9.8\%$, ne vitin 2018 raporti eshte $40.053/358.268=11.2\%$,ne vitin 2019 raporti eshte $59.569/326.839=18.2\%$, ne vitin 2020 raporti eshte $62.543/338.387=18.5\%$ dhe ne vitin 2021 raporti eshte $63.990/354.983=18\%$.

Norma e te ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit te pergjithshem te te ardhurave eshte perkatesishte: per vitin 2016 $-95.394/529.616=18\%$,ne vitin 2017- $97.451/421.986=23.1\%$,ne vitin 2018- $100.000/358.286=27.9\%$, ne vitin 2019- $107.577/326.839=32.9\%$,ne vitin 2020- $110.277/338.387=32.6\%$,dhe ne vitin 2021- $114.157/354.983=32.2\%$.

Norma e shpenzimeve kapitale ndaj shpenzimeve te pergjithshme ne vitin 2019 eshte planifikuar ne nivelin $42.873/318.689=13.5\%$, ne vitin 2020 eshte parashikuar ne nivelin $51.370/330237=15.6\%$, dhe ne vitin 2021 eshte parashikuar ne nivelin $49.516/346.833=14.3\%$.

Shpenzimet korrente ndaj shpenzimeve te pergjithshme jan perkatesishte: Per vitin 2018 $-275.816/318.689=86.5\%$, ne vitin 2020- $278.867/330.237=84.4\%$, dhe ne vitin 2021- $297.317/346.833=85.7\%$.

Treguesi me l rendesishem eshte raporti midis shpenzimeve per paga dhe sigurime ndaj totalit te pergjithshem te shpenzimeve.Perkatesishte ky tregues sipas viteve eshte: Viti 2019 $-197.792/318.680=62.1\%$, ne vitin 2020- $197.793/330.237=59.9\%$,dhe ne vitin 2021- $197.793/346.833=57\%$.

Norma e shpenzimeve per politikat sociale ka nje tren rrites nga 1.6 ne vitin 2016 ne 3.2 ne vitin 2020,kjo si rezultat l mbeshtetjes sociale me fondet e bashkise te familjeve ne nevojë por dhe te financimit te Qendres se Femijeve me Autizem(Qendra Alternative)po me fondet e bashkise.

Duke par keta tregues vem re se niveli shpenzimeve per paga dhe sigurime (shpenzimet e personelit) eshte l larte mesatarisht 60% e totalit te buxhetit.Nje buxhet duhe te kete raporte te balancuara midis shpenzimeve te personelit,shpenzimeve operative dhe investimeve.Eshte domosdoshmeri qe te ndryshojne keto raporte ne favor te investimeve dhe shpenzimeve operative pasi kjo l kontribuon zhvillimit ekonomik te zones por dhe permirsimit te performances financjare te bashkese.Synimi afatmesem duhe te jete rritja e shpenzimeve per investime ne 30% ,shpenzimeve operative ne 25% dhe per paga dhe sigurime te ulen nga 60% ne 45%.Por ka shume rendesi dhe raporti shpenzimeve te personelit sipas programeve buxhetore,duhe te rriten keto shpenzime ne sektoret qe ofrojne sherbimet jetesore si mirmbajtje,pastrim,gjelberim dhe te ulen shpenzimet e personelit administrative.

4.4.4-Rreziqet Financjare dhe Fiskale

Njesit e qeverisjes vendore jane te rrezikuara persa l perket aspektit financiar, arsyeja eshte se pothuajse gjysmen e burimeve buxhetore l parashikojne nga te ardhurat e veta dhe realizimi buxhetit eshte l lidhur ngushtesishte me nivelin e realizimit te te ardhurave.Ne vitet 2016,2017 bashkia ka realizuar buxhetin sipas zerave te planifikuar pothuajse 100%.Problem mbeten vitet e meparshme ne lidhje me realizimin e te ardhurave duke filluar qe nga viti aktual 2018.Realizimi te ardhurave te planifikuara si per vitin 2018 dhe parashikimi per vitet 2019-2021 eshte ne pikpyetje pasi dy aktivitetet nga te cilat bashkia realizon 40% te te ardhurave per momentin jane te pezulluara, nxjerrja e pllakave te gurut dhe nxjerja e mermerit.Te ardhurat dhe tarifat e tjera pak a shum kane nje trende rritjeje te vogel por te realizueshme me nje diference te vogel ne + ose -.Ndaj bashkise tone kane detyrime te palikujduara nder vite qoft biznesi,familjaret dhe bujku privat.Mundesit e arketimit te debitoreve jane te pakta.Pjesa mee madhe te debitoreve e ze bujku privat, kjo per arsye se shpopullimi fshatit .Njesit administrative ne baze te dokumetave kadastral te tokes perfituar sipas ligjit 7501, hartojne njoftim detyrimin per çdo perfitues te tokes dhe detyrimin e kontabilizojne por mundesit e mbledhjes se keti detyrimi jane te vogla pasi 70% e ketyre perfitueseve te tokes jane te larguar.Kjo sjell pamundesin e mbledhjes se takses tokes si per vitin aktual dhe per vitet e meparshme.

Si perfundim mund te themi se risqe ka por duke mare masat e duhura si intensifikimi punes per mbledhjen e detyrimeve te vitit aktual dhe atyre te prapambetura,planifikimi real l te ardhurave,menaxhimi mire i tyre evitimi shpenzime me pak te rendesishme rishikimi e shpenzimeve per paga dhe sigurime duke ngritur nje struktur organizative sa me efikase dhe duke eliminuar vende pune te panevojshme.

Faleminderit